

Vendim nr. 48 datë 12.03.2024

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë, i përbërë nga:

Holta Zaçaj,	Kryetare
Marsida Xhaferllari,	Anëtare
Marjana Semini,	Anëtare

në datën 12.03.2024 mori në shqyrtim paraprak kërkesën nr. 2 (I) 2024 të Regjistrimit Themeltar, që i përket:

KËRKUES: ISMET BORIÇI

OBJEKTI: Kërkesë për unifikimin e vendimeve nr. 19, datë 07.03.2007 të Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda; nr. 50, datë 01.11.2007 të Gjykatës së Apelit për Krime të Rënda; nr. 394, datë 08.07.2009 të Kolegjit Penal të Gjykatës të Lartë, si të papajtueshme me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë.

BAZA LIGJORE: Nenet 28, 131, pika 1, shkronja “f” dhe 134, pika 1, shkronja “i”, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë (*Kushtetuta*); ligji nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë” i ndryshuar (*ligji nr. 8577/2000*).

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese (*Kolegji*), pasi dëgjoji relatorin e çështjes Marjana Semini, shqyrtoi kërkesën, dokumentet shoqëruese, si dhe diskutoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N:

I

Rrethanat e çështjes

1. Kërkuesi Ismet Boriçi i është drejtuar Gjykatës Kushtetuese (*Gjykata*) me kërkesë për unifikimin e vendimeve të Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda (*GJKKO-ja e Shkallës së Parë*), Gjykatës së Apelit për Krime të Rënda (*GJKKO-ja e Apelit*) dhe Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë të dhëna ndaj tij për kryerjen e veprës penale “Vrasja në rrethana të tjera cilësuese”, të parashikuar nga nenet 79/e dhe 25 të Kodit Penal (*KP*).

2. Referuar rrethanave të çështjes rezulton se në datat 26 dhe 27.01.2004 kërkuesi në bashkëpunim me shtetas të tjerë kanë keqtrajtuar, për pasojë ka gjetur vdekjen shtetasi R.M.

3. Me vendimin nr.19, datë 07.05.2007, GJKKO-ja e Shkallës së Parë e ka deklaruar kërkuesin fajtor për kryerjen në bashkëpunim të veprës penale “Vrasja në rrethana të tjera cilësuese”, të parashikuar nga neni 79/e dhe 25 të KP-së, duke e dënuar me 25 vjet burgim.

4. Mbi ankimin e kërkuesit dhe të Prokurorisë për Krime të Rënda, GJKKO-ja e Apelit, me vendimin nr.50, datë 01.11.2007, ka vendosur lënien në fuqi të vendimit të GJKKO-së së Shkallës së Parë për kërkuesin dhe ndryshimin e këtij vendimi për të pandehurit e tjerë. Kundër këtij vendimi kërkuesi ka paraqitur rekurs.

5. Gjykata e Lartë, me vendimin nr. 394, datë 08.07.2009, ka lënë në fuqi vendimin e GJKKO-së së Apelit për kërkuesin, prishjen e vendimit për dy të pandehurit e tjerë dhe lënien në fuqi për ta të vendimit të GJKKO-së së Shkallës së Parë.

6. Kërkuesi në datën 29.12.2010 i është drejtuar Gjykatës për shfuqizimin e vendimeve të mësipërme, si të papajtueshme me Kushtetutën. Ndër të tjera, ai ka pretenduar se gjatë gjyqimit penal në GJKKO-në e Shkallës së Parë, në GJKKO-në e Apelit dhe në Gjykatën e Lartë, i është mohuar e drejta për t’u dëgjuar dhe mbrojtur si rrjedhojë e zhvillimit të gjyqimit në mungesë të tij. Sipas tij, gjykatat nuk kanë respektuar rregullat për njoftimin e të pandehurit, të parashikuara në Kodin e Procedurës Penale.

7. Gjykata, me vendimin nr. 26, datë 08.05.2012, ka rrëzuar kërkesën e tij duke çmuar se organet shtetërore kanë marrë të gjitha masat dhe kanë kryer të gjitha veprimet e mundshme, duke përmbushur detyrimet ligjore të parashikuara nga legjislacioni procedural penal si dhe nga Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut në lidhje me njoftimin personalisht të kërkuesit. Ai ka pasur dijeni për procesin penal në ngarkim të tij, por është larguar me vullnet të lirë nga Republika e Shqipërisë, duke zgjedhur, me vullnet të lirë, të mos marrë pjesë në procesin penal në ngarkim të tij, me qëllim për t’iu fshehur drejtësisë.

8. Në datën 04.01.2024 kërkuesi i është drejtuar sërish Gjykatës me ankim kushtetues individual, me objekt shfuqizimin e vendimeve të gjykatave të juridiksionit të përgjithshëm. Pas kthimit për plotësim, në përputhje me kërkesat e ligjit nr. 8577/2000, në datën 26.01.2024 ai ka paraqitur kërkesë me objekt unifikimin e vendimeve të gjykatave të juridiksionit të përgjithshëm

II

Pretendimet e kërkuetit

9. **Kërkueti**, në mënyrë të përmbledhur, ka pretenduar se gjatë gjykimit penal i është cenuar e drejta për t'u informuar për akuzën, si dhe e drejta për t'u mbrojtur.

III

Vlerësimi i Kolegjit

10. Çështja e legjitimitetit (*locus standi*) është një ndër aspektet kryesore që lidhet me nisjen e një procesi kushtetues. Sipas neneve 131, pika 1, shkronja "f" dhe 134, pikat 1, shkronja "i" dhe 2, të Kushtetutës, si dhe nenit 71 të ligjit nr. 8577/2000, çdo individ mund të vërë në lëvizje Gjykatën për gjykimin përfundimtar të ankesave kundër çdo vendimi gjyqësor që cenon të drejtat dhe liritë themelore të garantuara në Kushtetutë. Ankimi kushtetues individual, në çdo rast, duhet të plotësojë kriteret kumulative të nenit 71/a të ligjit nr. 8577/2000, që lidhen me shterimin e mjeteve juridike efektive, afatin e paraqitjes së kërkesës, pasojat negative të pësura në mënyrë të drejtpërdrejtë e reale, mundësinë për rivendosjen e së drejtës së shkelur, si dhe rregullimet e veçanta ligjore të shqyrtimit paraprak të kërkesës.

11. Rregullimet e veçanta në lidhje me shqyrtimin e kërkesave përcaktohen nga neni 31/a, pika 2, i ligjit nr. 8577/2000, në shtesë të kriterëve të mësipërme. Ato kanë të bëjnë me juridiksionin e Gjykatës, legjitimitetin formal të kërkuetit dhe të përfaqësuesit, si dhe me respektimin dhe vlerën e vendimmarrjeve të mëparshme të Gjykatës. Ky kriter i fundit përcaktohet nga shkronja "dh" e pikës 2 të nenit 31/a, sipas së cilës, nëse kërkimet e paraqitura në kërkesë janë objekt i një vendimi të mëparshëm, vendoset moskalimi i çështjes për shqyrtim në seancë plenare.

12. Në rastin konkret, Kolegji vëren se kërkesat e ankuesit kanë për objekt shfuqizimin, si të papajtueshëm me Kushtetutën, të vendimeve të GJKKO-së së Shkallës së Parë, GJKKO-së së Apelit dhe Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë, si dhe unifikimin e vendimeve të GJKKO-së së Shkallës së Parë, GJKKO-së së Apelit dhe Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë. Në lidhje me këto vendime kërkueti i është drejtuar Gjykatës për shfuqizimin e tyre në datën 29.12.2010 dhe me vendimin nr. 26, datë 08.05.2012, Gjykata ka vendosur rrëzimin e kërkesës. Pavarësisht objektit, në thelb ai ngre të njëjtat pretendime me kërkesën e mëparshme.

13. Për sa i përket unifikimit ose njësimimit të praktikës, në jurisprudencën e saj Gjykata ka theksuar se neni 141 i Kushtetutës i ka dhënë Gjykatës së Lartë kompetencën e shqyrtimit të çështjeve lidhur me kuptimin dhe zbatimin e ligjit për të siguruar njësimin ose zhvillimin e praktikës gjyqësore sipas ligjit (*shih vendimet nr. 17, datë 23.03.2023; nr. 17, datë 30.03.2021 të Gjykatës Kushtetuese*). Në këtë kuptim, njësimi i praktikës gjyqësore përfshihet në

kompetencat kushtetuese të Gjykatës së Lartë, për rrjedhojë Kolegji vlerëson se pretendimet e parashtruara në këtë drejtim nuk përfshihen në juridiksionin e Gjykatës.

14. Për sa i përket rishqyrtimit të kërkesave, Gjykata në praktikën e saj ka pranuar rishqyrtimin e kërkesës së të njëjtit individ, me të njëjtin objekt, kur përmes një kërkesë tjetër, brenda afatit ligjor të parashikuar nga ligji nr. 8577/2000, ka argumentuar një shkak të ri për antikushtetutshmërinë e aktit të kundërshtuar (*shih vendimin nr. 21, datë 29.04.2010 të Gjykatës Kushtetuese*).

15. Në rastin konkret, kërkuesi ka paraqitur ankim kushtetues individual, të cilin e ka formuluar si kërkesë për unifikimin e vendimeve të gjykatave të juridiksionit të përgjithshëm, ndërsa në thelb kërkon shfuqizimin e tyre dhe kthimin e çështjes për rigjykim në këto gjykatat. Duke mbajtur në konsideratë se shkak i paraqitur në këtë ankim është i njëjtë me shkaqet për të cilat Gjykata është shprehur më parë me vendimin përfundimtar nr. 26, datë 08.05.2012, atëherë, bazuar në nenin 31/a, pika 2, shkronja “dh”, të ligjit nr. 8577/2000, Kolegji çmon se çështja nuk mund të kalojë për shqyrtim në seancë plenare.

16. Në përfundim, Kolegji çmon se ankimi kushtetues individual nuk plotëson kriteret ligjore paraprake për pranimin e tij për shqyrtim në seancë plenare.

PËR KËTO ARSYE,

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese, bazuar në nenet 31 dhe 31/a, pika 2, shkronja “dh” të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar,

V E N D O S I:

Moskalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare.